

Kosovë: O Partitë, O Shtetin?!

**Shkruan:
Faton H. Bislimi**

**Boston, SHBA
3 Mars 2006**

Termeti i fundit politik në Kosovë është cilësuar në mënyra të ndryshme si nga faktorët e brendshëm ashtu edhe nga ata të jashtëm. Disa e cilësojnë vetëm si “proces normal të demokracisë,” disa sikur “tronditje e rëndë politike,” disa sikur “gjë të domosdoshme, bile të stërvonuar.” Mandje, disa edhe “janë gëzuar” e disa të tjerë “janë dëshpëruar.” Por, ajo që ndodhi, nodhi. Brenda pak më shumë se një muaji Kosova ndërron krejtësisht petkun hiarkik të politikës. Humbi Presidentin e saj të parë dhe themeltarin e bërthamës së shtetit të Kosovës, Dr. Rugovën, dhe pos asaj, tani edhe ndërroi Qeverinë pas dorëheqjes së Kryeministrit Kosumi, dhe është në ndërrim edhe të Kryeparlamentarit Daci, pas vendimit të Kryesisë së LDK-së për zëvendësimin e tij nga Nënkryetari i LDK-së Kolë Berisha.

Dhe, për ata që fare pak dijnë për demokracitë perëndimore, është e lehtë të kuptohet se çfarë në të vërtetë po ndodhë në Kosovë. Për ata që e kuptojnë ecurinë e proceseve politike në demokracitë e denja, nuk ka dyshim se spastrimi politik në Kosovë cilësohet si ngjarje jo vetëm e rëndësishme, por edhe shokuese. E për dikë, nuk ka qenë fare shokuese, sepse ka të tillë që edhe e kanë pritur dita-ditës këtë termet politik. Seizmo-politikologët e tillë pa dyshim se nuk ndjehen të shokuar. Ata janë eksperët. Gjithëçka është ditur nga ta qysh më heret. Kurse, për jopolitikologët dhe njerzit e rëndomtë, paksa e gjithë kjo shihet jo vetëm me skepticizëm por edhe me habi. Më në fund, një gjë është e kjartë – dikush duhet përgëzuar për gjithë këtë, dhe ai është populli i

Kosovës që po tregohet burrëror, ashtu siç i ka hije shqiptarit, dhe ashtu siç diti të përcjellë me shumë maturi dhe respekt Kryetarin e tij të parë, por pas tij tani ta përshëndes edhe Kryeministrin e Kryeparlamentarin.

Për ata që gjejnë pak kohë të merren me analiza të thukta të mënyrës së ekzistimit të demokracisë politike, dhe jo me paragjykime dhe superfikime, është e lehtë të kuptohet se ndodhitë e fundit politike në Kosovë aspak nuk janë të zakonata. Gjerësa Kosova pretendon të jetë një vend demokratik, Kosova atëherë ka treguar edhe shembullin më tipik dhe të pazakontë, që demokracitë e tjera të brishta dhe në rritje sikur kjo e Kosovës me siguri do të kishin dështuar ta jepnin – dhe kjo qëndron në faktin se Kosova nuk është futur në krizë politike e institucionale ENDE! Pra, ende nuk është futur në një krizë të tillë. Dhe, na mbetet të shpresojmë që kjo gjakftohtësi të ruhet dhe shembulli i nisur të përfundohet dhe të mbetet tipik për demokracitë tjera në ndërtim e sipër. Shembull ky me të cilin habiten edhe demokracitë e vjetra shumëvjeçare.

Nuk don koment, se të cilësohet e gjithë kjo ndodhi e brenda një dite si “e zakonitë” dhe si “proces normal demokratik” është jo vetëm superfiktive, por edhe démodé. Këtyre ekspertëve të procesve të zakonata dhe normale demokratike duhet shtruar pyetja se në cilin nga vendet, jo vetëm në tranzicion, por edhe në vendet me demokraci të vjetra shumëvjeçare, ka ndodhur që të bëhen kaq ndryshime të mëdha politike brenda një dite, nën direktivat e linjave partiake?!

A thua vallë, Amerikanët, demokracinë e tyre që ne zakonisht e cmojmë deri në kulm, dhe me të cilët “duam të jemi në miqësi të përherëshme” nuk e kuptojnë se çfarë është demokracia dhe “proceset normale demokratike” dhe të “zakonta”?! Sipas kësaj demokracisë ala-Kosovarçe, amerikanët, gjegjësisht strukturat politike të Partisë Republikane, që në masë të madhe, kanë qenë kundër luftës në Irak dhe kundër planit të Administratës së Presidentit Bush për strategjinë e Irakut, është dashur që në momentet më kritike për vendin e tyre të kërkojnë shkarkimin e personaliteteve më të larta të qeverisjes, sepse na paskan gabuar në strategjinë e tyre?! Kurse, Partia Demokratike në SHBA është dashur që menjëherë të vihet në ballë të kësaj ideje për shkarkime në këtë

kohë kritike për Amerikën, duke thenë se “ne kemi kërkuar që këto shkarkime të ndodhin më herët” dhe mirë që u bënë. Apo, kur Presidenti Bush është kritikuar skajshmërisht nga liderë botëror për veprimet e tij, përsëri sipas demokracisë ala-Kosovarçe, partia e tij është dashur menjëherë ta shkarkojë atë, sepse “po na i hidhërojka miqtë ndërkombëtarë.” E po edhe këta Amerikanët, çfarë mendonin të gjojnë??? Sot me siguri do t’i kishin punët shumë më mirë sikur të kishin ditur këta se si funksionin demokracia ala-Kosovarçe, apo jo?! Por, nga “mosdija” dhe nga “mospërvoja” në demokraci, Amerikanët e gjojnë, në momentet më kritike për vendin, edhe në kohën kur nuk pajtoheshin përgjithësisht me vendimet e liderit të tyre, Presidentit të vendit, bashkoheshin pas tij. Dhe jo vetëm amerikanët republikanë, por edhe ata demokratë, gjithënjë janë vënë pas liderit të tyre në kohët kritike për vendit. Mos të harrojmë 11 Shtatorin: Edhe Klintoni edhe gjithë demokratët menjëherë kishin përvjelur mangët për t’u vënë në përkrahje të Presidentit të tyre, sado që politikisht mund ta mos e pëlqejnë dhe të mos e dëshirojnë. Kur është në pyetje vendi, partitë e politika mbetet në marginë sipas demokracisë Amerikane, kurse sipas kësaj të Kosovës, gjithëcka tjetër është e dorës së dytë, kurse platformat partiake, që fatmirësisht bile të paktën në shumicën e rasteve janë kombëtare, janë prioritet.

Fatkeqësisht, deri më tani, as Amerikanët nuk e kanë ditur këtë lloj operimi të demokracisë, por tash që e dijnë, apo që e kanë mësuar në Kosovë, ndoshta duhet ta sjellin këtë përvojë edhe në SHBA. Atëherë, le të shohim se si do të kalonin ata që proklamojnë këtë lloj demokracie?! Ata që besojnë në këtë demokraci, para se të eksperimentojnë në Kosovë, duhet që së pari të ekperimentojnë në vendin e tyre.

Është e vërtetë se fati i një vendi dhe një kombi assesi nuk mund të lidhet me një individ, apo një Qeveri, apo një Kuvendar, aq sa është e vërtetë edhe fakti se ndryshimet në Qeverinë e Kosovës kanë qenë të nevojshme. Në të njejtën kohë, është gjithashtu e vërtetë se Qeveria e Kosovës është treguar herë-herë joefikase dhe e papërgatitur për të luajtur rolin e duhur si ekzekutiv vendor. Porse, a ka qenë kjo koha më e përshtatshme për ndryshime rrënjësore në lidërsipin institucional të Kosovës? A duhet që Parlamenti i Kosovës tani të merret me votime pro e kundër shkarkimit të Kryekuvendarit, e zgjedhjes së Qeverisë së re, apo me punën më të rëndësishme për popullin e Kosovës – përgatitjet

për arritjen deri tek definimi pozitiv i statusin final të vendit? Apo ndoshta, është dashur të mendohet edhe për gjërat më praktike që po rëndojnë jetën e Kosovarëve dita-ditës – sikur mosfurnizimi me rrymë elektrike?!

Pra, gjithësecili prej nesh ndoshta mund të japë dhejtra e dhejtra arsye se cilat janë shkaqet e ndryshimeve të krerëve institucional të Kosovës dhe pse këto ndryshime është dashur të ndodhin, por ajo që është shumë vështirë të argumentohet në bazë analitike dhe të arsyeshme është koha, në të cilën ndodhi i gjithë ky termet politik, ka qenë e duhur dhe e përshtatshme. Sidoqoftë, edhe pse kjo ndodhi politike aspak nuk ka të bëjë me realitetin e funksionimit të demokracive të denja, na mbetet që të paktën të shpresojmë se vendimet e politikanëve tonë nuk ishin krejtësisht dhe thellësisht të gabuara. Na mbetet të shpresojmë se ndoshta, e theksoj ndoshta, Kosova po krijon një shembull në pazakontë në demokraci. Dashtë Zoti e qoftë ashtu.

Tutje, është vështirë të paramendohet se si ky hap dramatik i lidërshiptit politik Kosovar shkon në favor të “ecjes përpara të proceseve,” kur kihet parasysh fakti se vendimet për krerët e institucioneve dhe pozitat e tyre merren nga partitë. Kjo pra është rrënja e tragjedisë politike të Kosovës. Partia në Kosovë ende ka rolin kryesor, dhe jo vota e popullit. E t’i vlerësosh më lartë vendimet partiake sesa ato të institucioneve të zgjedhura me votën e popullit, nuk tingëllon aspak demokratike. Ndoshta, edhe për këtë çështje duhet pyetur “miqtë tanë ndërkombëtarë” nëse një gjë e tillë do të konsiderohej demokratike nëpër vendet e tyre me demokraci shumëvjeçare?!

Është e natyrshme që partitë politike, që shërbejnë si baza të ngritjes karrieriste të individëve nëpër poste të institucioneve e shtetërore, kanë rol të rëndësishëm mandej edhe në veprimet e këtyre individëve, por ky rol assesi nuk duhet lejuar të tejkalojë fuqinë e votës së popullit. Amerikanët nuk kanë qenë budallenjë kur kanë vendosur që institucionet shtetërore të zgjidhen drejtpërdrejtë me votën e popullit. Dhe, për secilin Kongresist me të cilin baza e tij elektorale nuk është e kënaqur ekziston mundësia e largimit nga karriga e Kapitol Hillit nga po kjo bazë elektorale që e ka qar atje. E njejta gjë velën edhe për Presidentin. Populli e zgjedhë Presidentin e Amerikës, dhe po i njejti

ka mundësi edhe ta dërgojë atë në rançin e tij në Teksas po të don. Gjerësa të zgjedhurit e popullit, pra Kongresistët, janë ata që me shumicë votash mund të kërkojnë edhe largimin e secilit nga anëtarët e Kabinetit të Presidentit të SHBA-ve, pra secilin nga Ministrat (apo Sekretarët). Por, partia assesi nuk e ka këtë kompetencë.

Fatkeqësisht, sistemi elektoral në Kosovë i ka lejuar partive këtë mënyrë të kontrollit të shtetit nga selitë e tyre. Pra, nuk është as edhe faji i partisë, por është faji i atyre që na kanë imponuar një sistem të tillë zgjedhur, që lejon shumë pak mundësi për përgjegjësi publike dhe etikë në vendimmarrje.

Dhe, kështu pra vijmë tek rrënja e problemit. Problem ky që tani manifestohen në mënyra të ndryshme për kalkulime të ndryshme politike dhe partiake. Por, e gjithë kjo ndodhi do të mund të kthehej eventualisht në një synergj të re ndoshta për hapa të drejtë më tutje. Dhe, efekte pozitive mund të priten vetëm nëse gjithëcka shkon pa pasoja politike dhe nëse Qeveria e ardhëshme dhe të nominuarit e rinj në krye të institucioneve të Kosovës arrijnë që t'i mos i përsërisin gabimet e të së kaluarës. Kosova mund të krijojë një Qeveri më të mirë vetëm nëse në të involvon njerzit profesionistë dhe ekspertët e duhur, e jo piunët politiko-partiakë. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se të gjithë ata që kanë shërbyer në Qeverinë Kosumi duhet bartë plaçkat – assesi. Qeveria tani në dorëheqje ka patur njerzë që gjithësesi kanë qenë energjetikë, të denjë, dhe me kualitete të larta profesionale në punët e tyre. Ata duhet të vazhdojnë të çojnë përpara programet e nisura. Është përgjegjësi e mandatarit të ri të Qeverisë së Kosovës që tani të krijojë një kabinet të fortë profesionalisht dhe etikisht dhe të çojë Kosovën në realizimin e aspiratave të kahmotëshme. Pasojat mund lehtë të evitohen kur sukseset e ardhëshme i tejkalojnë fuqishëm dëmet e tashme.

Sidoqoftë, ajo që është bërë nuk ç'bëhet, por mbetet për t'u parë, me shpresë, se Kosova edhe këtë termet do ta përballojë me sukses, jo për hirë të partive assesi, por për hirë të popullit dhe vendit. Dhe, partitë duhet që të ndihmojnë të funksionalizojnë institucionet e Kosovës sa më shpejtë që të jetë e mundur, dhe të orientohen nga demokracia e vërtetë perëndimore e jo nga ajo ala-Kosovarçe. Kjo është koha më kritike

për gjithë kombin tonë, e veçanërisht për Kosovën. Sfida kryesore që duhet zgjedhur sa më shpejt që të mos kemi kësi lloj termetesh në të ardhmen na detyron të zgjedhim o partitë, o shtetin. Dhe, gjerësa opcioni i parë vjen e shkon, i dyti mbetet për gjithmonë.

Autori është duke magjistruar në Administratë Publike dhe Marrëdhënie (Zhvillim) Ndërkombëtare në Shkollën Postdiplomike të Qeverisjes John F. Kennedy të Universitetit të Harvardit në Cambridge, SHBA. Ai është nderuar me tillutin më prestigjioz për kandidatët e magjistraturës Kennedy Fellow të kësaj shkolle me renome botërore.

Ju lutem mos hezitoni që komentet tuaja në lidhje me këtë publikim t'i dërgoni përmes faqës sonë në internet (nën rubrikën "Komentet"). Komentet tuaja janë gjithëherë të mireseardhura.

The Bislimi Group

www.bislimi.org